



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 366/2 Prot.

Tiranë, më 18.03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 61, Datë 18.03.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 27, datë 29.02.2024, e paraqitur nga z. I.D kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në të cilën pretendohet për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se:

*“Rasti 1 (parashtrohet pasi lidhet me Rastin 2 që lejon kërkesën për rishikim).*

*Ankuesi në kuadër të rritjes dhe promovimit në karrierë, ndër radhët e lektorëve të Fakulteteve të Drejtësisë, në përputhje me ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ka dorëzuar pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës, kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për kandidimin e tij në pozicionin “Anëtar i Kolegjit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Kolegjit të Lartë të Prokurorisë (KLP)”.*

*Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, në cilësinë e titullarit të këtij institucioni, ka mbajtur pa asnjë shkak ligjor, dosjen me dokumentacionin e ankuesit, duke ndikuar kështu me mosveprimin e tij, në pengimin e ushtrimit të së drejtës së ligjshme të ankuesit, si dhe duke e vendosur në një gjendje më pak të favorshme përkundrejt kandidatës tjetër (Y.R), për të njëjtat pozicione.*

<sup>1</sup> Për shkak të ankesave për paligjshmëri që kam bërë ndaj Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe nga Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Ankuesi sqaron se në datat 04.10.2021 dhe 07.10.2021, i është drejtuar zyrtarisht me kërkesë, Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, duke i kërkuar informacion mbi dosjet e tij. Ankuesi ka paraqitur kërkesë edhe pranë Rektorit të Universitetit, kërkesë e cila nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e Rektorit.

Pavarësisht kësaj, është arritur të mundësohet përcjellja e dokumentacionit, si kandidaturë për pozicionin e anëtarit të njërit prej organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ndërkohë që kjo duhet të ishte realizuar në përputhje me ligjin dhe procedurën e parashikuar në nenin 40, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar. Kjo shkelje pasohet gjithashtu me mohimin e të drejtës së ankimit, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Kjo sjellje e bën akoma edhe më të rëndë situatën e paligjshmërisë, duke thelluar akoma dyshimet lidhur me qëndrimin paragjykes të Dekanit, me qëllim pengimin dhe vendosjen në një situatë më pak të favorshme, në ushtrimin e drejtë dhe të barabartë të të drejtave themelore të ankuesit.

Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, ka marrë pjesë në Mbledhjen e Posaçme të Rektorëve dhe Dekanëve të zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me datë 12.10.2021, takim ky në të cilin ju mund të evidentoni konkretisht<sup>2</sup>, paligjshmërinë e veprimeve të këtij subjekti dhe qëndrimin paragjykes të tij ndaj meje.

Si rezultat, ne arrijmë në përfundimin se sjellja e Dekanit e mbështetur dhe nga Rektori me mosveprime, duke shmangur përmbushjen e detyrimeve ligjore për rastin në fjalë, janë haptazi të paligjshme, të qëllimshme dhe rrjedhimisht diskriminuese, me qëllim pengimin dhe vendosjen në një situatë më pak të favorshme të ankuesit, në drejtim të ushtrimit të të drejtave në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar - Rasti 2 (Shkaku i rishikimit).

Në kuadër të qëllimit për të penguar vijimin e garës nga ana e organeve të USH-së (Fakulteti dhe Rektori) është përcjellë një shkresë për masë disiplinore “Largim nga puna”. Nga ana e Këshillit të Etikës, pavarësisht kërkesës është vendosur me shumicë votash dhënia e një masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”. Kjo masë disiplinore ishte e padrejtë dhe e paligjshme, e motivuar për të penguar vijimin e garës si kandidat potencial. Kjo duket qartë, që pavarësisht se çështja ishte dërguar në gjykatë dhe pritej gjykimi nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nga ana e Rektores me shkresë nr. 3442, datë 28.12.2021, dërgohet shkresë zyrtare duke bërë njoftime se ankuesit si kandidat i ishte dhënë masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”. Kjo sjell skualifikimin nga gara si kandidat, në mënyrë të padrejtë.

Në datë 22.11.2021, ankuesi ka depozituar padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me palë ndërgjyqëse I.D si paditës dhe palë e paditur Universiteti i Shkodrës, me objekt:

---

<sup>2</sup> Linku: <https://fb.watch/8-TdxN5PTM>

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute/paligjshmërisë të Vendimit nr. 330, datë 09.11.2021 të Këshillit të Etikës të Universitetit të Shkodrës për marrjen e masës “Vërejtje me shkrim” të dhënë për subjektin paditës.

Pas shqyrtimit të kërkesëpadisë së ankuesit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin nr. 145 (1860), datë 28.02.2023, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit I.D.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 330, datë 09.11.2021 të Këshillit të Etikës të Universitetit të Shkodrës për masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”.

Bazuar edhe në interpretimin dhe gjetjet e Gjykatës, kuptohet se shkelja e rëndë e ligjit material dhe procedural nga ana e palës së paditur ka ardhur në rrethanat kur pala e paditur ishte e detyruar dhe duhej të merrte dijeni për çfarë parashikon ligji, lidhur me përbërjen e një organi kolegjal, siç është Këshilli i Etikës, dhe të vepronte në përputhje me kërkesat ligjore, në kuadër të parimit të procesit të rregullt ligjor dhe parimeve të tjera kushtetuese. Megjithatë, pala e paditur ka vepruar në shkelje flagrante të ligjit, duke nxjerrë një akt absolutisht të pavlefshëm, pavarësisht dijenisë së qartë të pavlefshmërisë absolute të këtij akti, e provuar gjyqësisht, duke pasur një sjellje të qëllimshme diskriminuese ndaj ankuesit.

Lidhur me qëndrimin subjektiv të palës së paditur, referojmë dhe në parimin e përgjegjshmërisë (neni 14 i K.Pr. Administrative), pala e paditur ka shfaqur me dijeni të plotë shkallë të lartë papërgjegjshmërie dhe rrjedhimisht sjellje abuzive dhe paragjyquese, duke diskriminuar ankuesin nëpërmjet një procesi të parregullt dhe të pavlefshëm ligjor.

Vendimmarrja e gjykatës mbi një sjellje dhe qëndrim jo ligjor të institucionit ndaj ankuesit, me pasoja të rënda dhe në një farë pike të pariparueshme për këtë të fundit, në kundërshtim të hapur me qëllimin që ka ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, referohet si një provë më se e mjaftueshme për të rishikuar pozitën e ankuesit dhe vendimmarrjen fillestare të bërë nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 9, datë 10.01.2022, në lidhje me provueshmërinë e kërkesës për pretendimin për diskriminim nga ana e institucionit, konkretisht Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave të tjera ndaj shkelësve të ligjit që do të vlerësohen të përshtatshme për rastin, nga ana e Komisionerit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore,

*predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 12, pika 1, germa c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, z. I.D me ankesën nr. 226, datë 02.12.2021, drejtuar KMD-së, ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e z. G. K, Dekan i Fakultetit të Drejtësisë dhe znj. E. B, Drejtor i Departamentit Civil, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, për “*çdo shkak tjetër*”<sup>3</sup>. Ankuesi ka kërkuar nga KMD-ja, ndërprerjen e veprimeve diskriminuese ndaj tij, si dhe marrjen e masave për t’i rikthyer të gjitha të drejtat dhe pozitën që ka patur para veprimeve diskriminuese të kryera nga ana e subjekteve të sipërcituara. Ankuesi kërkon rikthimin e

<sup>3</sup> “Mendimet e ndryshme në raport me trajtimin e studentëve, procesin e mësimdhënies dhe problematikave, që shqetësojnë Fakultetin e Drejtësisë në tërësi, duke mos qënë “krah” me qëndrimet e tij, përbëjnë shkakun e diskriminimit”.

ngarkesës në lëndët që ka patur para diskriminimit të ndodhur si dhe rikthimin e tij për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve të së drejtës “E drejtë procedurale civile”.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri me Vendimin nr. 9, datë 10.01.2022<sup>4</sup>, ka vendosur: “1. Mospranimin e ankesës nr. 226, datë 02.12.2021, të z. I.D, pasi është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.

Në vendimin e sipërcituar, Komisioneri në mes të tjerash ka arsyetuar se: “Komisioneri gjykon se kur ekziston një konflikt midis dy ose më shumë palëve, të gjithë palët e shprehin mosdakordësinë e tyre mbi çështje të caktuara. Në këtë kontekst, Komisioneri ka konstatuar problematika dhe mosdakordësi të ankuesit me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, lidhur me çështje të ndryshme, të cilat janë shprehur qartë në shkresat e sipërcituara. Ndërkohë që, nuk rezultojnë të jetë paraqitur asnjë akt në cilësi prove, ku të reflektohet reagimi zyrtar i Dekanit lidhur me këto konflikte apo mosdakordësi me ankuesin.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se konflikti apo mosdakordësia ndërmjet palëve, lidhur me shkakun e pretenduar të diskriminimit, është vërtetuar në mënyrë të njëanshme.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesi për Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër rezultojnë i paprovuar.

Komisioneri nuk arrin të kuptojë një lidhje midis veprimeve të pretenduara dhe konfliktit të prezumuar, si shkak me karakteristika të veçanta për tu klasifikuar si shkak diskriminues sipas parashikimit “për çdo shkak tjetër”, të nenit 1 LMD”.

Së dyti, në ankesën objekt shqyrtimi z. I.D, pretendon se diskriminohet nga Universiteti i Shkodrës, për shkak të ankesave për paligjshmëri që ka bërë ndaj Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe nga Rektori i Universitetit.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e vendimit për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezultojnë se:

- Ankuesi në datat 04.10.2021 dhe 07.10.2021, i është drejtuar zyrtarisht me kërkesë, Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, duke i kërkuar informacion mbi dosjet që ka dorëzuar pranë Fakultetit të Drejtësisë, për kandidimin e tij në pozicionin “Anëtar i Kolegjit të Lartë Gjyqësor dhe Kolegjit të Lartë të Prokurorisë”.

<sup>4</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/02/Vendim-nr.-9-date-10.01.2022-I.D.-kunder-G.K-Dekan-Fakulteti-Drejtësisë-Universiteti-Luigj-Gurakuqi-Shkoder-dhe-E.B-Mospranim.pdf>

- Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, me datë 12.10.2021, ka marrë pjesë në Mbledhjen e Posaçme të Rektorëve dhe Dekanëve të zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në të cilën ankuesi pretendon se Dekani ka kryer veprime të paligjshme dhe ka mbajtur qëndrim paragjykes ndaj tij.
- Këshilli i Etikës të Universitetit të Shkodrës me Vendimin nr. 330, datë 09.11.2021, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj pedagogut I.D.
- Në datë 22.11.2021, z. I.D ka depozituar padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në të cilën ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 330, datë 09.11.2021 të Këshillit të Etikës të Universitetit të Shkodrës.

Referuar informacionit të sipërcituar, rezulton se periudha e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është në datë 04.10.2021, kur ankuesi i është drejtuar me kërkesë Dekanit, për dokumentacionin për kandidimin e tij në pozicionin për anëtarë i KLGJ dhe KLP dhe në datë 09.11.2021, kur ka marrë dijeni për masën disiplinore, fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesi në pikën 7 dhe 8 të formularit të ankesës. Ndërkohë që, edhe data e konstatimit të diskriminimit nga ana e ankuesit është 22.11.2021, kur ka depozituar padinë për kundërshtimin e masës disiplinore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është periudha gjatë muajve tetor-nëntor 2021, kur ankuesi i është drejtuar me kërkesë Dekanit dhe kur është marrë masa disiplinore. Edhe momenti i marrjes dijeni nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga Universiteti i Shkodrës është data 22.11.2021. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 29.02.2024. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 27, datë 29.02.2024 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>5</sup>.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 27, datë 29.02.2024, të z. I.D, pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: *“Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.*

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: *“Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.*

<sup>5</sup> Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023 dhe nr. 167, datë 23.08.2023 të Komisionerit.



Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj<sup>6</sup>, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t'i drejtohet gjykatës kompetente.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 27, datë 29.02.2024, të paraqitur nga z. I.D kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>6</sup> Neni 36 i Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar: “*Procedura para gjykatës*”.